



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLAnr.119/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova Kryesuese, Hajriz Hoti, dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik GI Novo Lice – Narodna Pravda, me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 08.10.2025, merr këtë

VE N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR ankesa ZLAnr.119/2025, e datës 06.10.2025, parashtruar nga subjekti politik GI Novo Lice – Narodna Pravda, me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 06.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë në të cilën pretendohet se me datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" në komunën e Leposaviqit, vunë re se aktivistët e Listës Serbe në këtë komunë, në vendin Soçanicë, kishin ngjitur materialin e tyre promovues në dy shtylla elektrike në vendkalimin këmbësor, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Si prove në ankesë ka bashkangjitur fotografi që dëshmon vendosjen e materialit në shtylla elektrike.

Në përgjigje në ankesën subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, në të cilën pretendohet se përkrahësit e subjektit politik Srpska Lista kishin vendosur material promocional në urën në rrugën Mitrovicë e Veriut - Leposaviq, në vendin Soçanica, dhe kështu shkelën Rregullat Zgjedhore në lidhje me vendosjen e materialit promocional të Srpska Lista, në territorin e komunës së Leposaviqit, theksojmë se kjo është e pasaktë, se materiali i përmendur është hequr më 03.10.2025, në përputhje me vendimin e PZAP-së të marrë më 03.10.2025, në bazë të ankesës ZL.Anr. 87/2025, dhe për shkak të së cilës subjekti ynë politik është ndëshkuar dhe njëkohësisht ka paguar dënimin e parashikuar në përputhje me dispozitat ligjore.

Si provë në përgjigje në ankesë e kanë bashkëngjitur në shtojcë fotografitë në të cilat shshifet se materiali promocional i përmendur është hequr.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, të subjektit politik GI "Novo Lice - Narodna Pravda" dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Srpska Lista, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik GI "Novo Lice - Narodna Pravda", janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *"Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve."*

Paneli ka gjetur se në bazë të shkresave të bashkëngjitura në përgjigje në ankesë nga subjekti politik Srpska Lista kanë vërtetuar faktin se materialin e tyre promovues në dy shtylla elektrike në vendkalimin këmbësor të e vendosura janë larguar, gjë që vërtetohet edhe me fotografitë bashkëngjitur kësaj përgjigjeje.

Sipas vlerësimit të panelit konstatohet se subjekti politik Srpska Lista, ka ndërmarrë veprime për largimin e materialeve, ashtu siç është urdhëruar sipas vendimit të PZAP-se ZL.Anr.87/2025 të datës 30.09.2025.

Andaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *"vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës, nuk kane mbështetje në prova, dhe të njëjtën e refuzoi si të pazbatueshme.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.119/2025 më datë 08.10.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.